



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

SEKSIONI I DYTË

Kërkesa nr. 41680/13
Milorad ULEMEK
kundër Serbisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), e mbledhur më 2 shkurt 2021 si Dhomë, e përbërë nga:

Jon Fridrik Kjølbros, *President*,

Marko Bošnjak,

Aleš Pejchal,

Valeriu Grițco,

Egidijus Kūris,

Carlo Ranzoni,

Pauliine Koskelo, *gjyqtarë*,

dhe Stanley Naismith, *Sekretar i Seksionit*,

Duke marrë parasysh kërkesën e përmendur më lart të depozituar më 3 qershor 2013,

Duke marrë parasysh konstatimet e parashtruara nga palët,

Duke vërejtur se Branko Lubarda, gjykatësi i zgjedhur në emër të Serbisë, u tërhoq nga gjykimi i çështjes (neni 28 § 3 i Rregullores së Gjykatës) dhe se, për rrjedhojë, Presidenti i Dhomës emëroi Carlo Ranzonin si gjykatës *ad hoc* në përbërje të trupit gjykues (neni 26 § 4 i Konventës dhe neni 29 § 2 i Rregullores së Gjykatës),

Pas shqyrtimit të çështjes, vendos si më poshtë:

FAKTET E ÇËSHTJES

1. Kërkuesi, z. Milorad Ulemek, është shtetas serb, i lindur në vitin 1968 dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin me burg në burgun e Zabelës në Pozharevc. Ai u përfaqësua para Gjykatës nga z. A. Kovačević dhe z. Milivojević, avokatë që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Beograd.

2. Qeveria serbe (“Qeveria”) u përfaqësua nga agentja e saj në atë kohë, znj. N. Plavšić.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

3. Më 2 dhjetor 2015, qeveria u njoftua për kërkesat e kërkuetit në pajtim me nenin 7 § 1 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës ndërsa pjesa e mbetur e kërkesës u shpall e papranueshme në përputhje me nenin 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës.

A. Rrethanat e çështjes

4. Faktet e çështjes siç ato janë parashtuar nga palët mund të përmbliidhen si më poshtë.

1. Proceset për konfiskimin e pasurive të kërkuetit

5. Nga viti 2007 deri më 2009 kërkueti u gjykua si drejtues i një grupi të organizuar kriminal për një sërë krimesh të rënda që ai kishte kryer në periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2003 dhe u dënua me 40 vjet burgim.

6. Më 29 mars 2010, Zyra e Prokurorit për Krimin e Organizuar ("Prokurori") parashtroi një kërkesë për konfiskimin e pasurisë së kërkuetit në përputhje me Ligjin "Për sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi" (*Zakon o oduzimanju imovine proistekle iz krivičnog dela*) (më poshtë "Ligji i 2008-ës"; shih paragrafin 23 më poshtë).

7. Objekti i kërkesës së Prokurorit ishte shtëpia e kërkuetit, të cilën ai e kishte blerë në vitin 1998 për 374,409 marka gjermane (DM) (afërsisht 190,000 euro (EUR)). Prokurori pretendonte më tej se të ardhurat e përgjithshme të ligjshme të kërkuetit nga viti 1996, kur ai kishte filluar të punonte në Shërbimin Sekret të Ministrisë së Brendshme, deri në vitin 1998, kur ai kishte blerë shtëpinë, kishin qenë vetëm 22,789 DM (afërsisht 11,650 euro), më pak se një e pesëmbëdhjeta e shumës që kishte paguar për pronën. Duke qenë se kishte një mospërputhje të dukshme midis fitimeve të ligjshme të kërkuetit dhe vlerës së pronës së tij, dhe duke qenë se ai ishte dënuar si anëtar i një grupi të organizuar kriminal, Prokurori kërkoi konfiskimin e shtëpisë në fjalë.

8. Më 20 maj 2010, Dhoma e Posaçme e Gjykatës së Lartë të Beogradit pranoi kërkesën e prokurorit dhe lëshoi një urdhër konfiskimi. Gjykata arsyetoi se kishte mospërputhje të dukshme midis fitimeve legjitime të kërkuetit dhe vlerës së pasurisë së tij. Meqenëse kërkueti nuk kishte siguruar asnjë provë të mundshme që dëshmonte se ai e kishte fituar pronën e kontestuar me të ardhura të fituara në mënyrë të ligjshme, dhe duke qenë se ai ishte dënuar për krime të rënda me elementë të krimit të organizuar përmes të cilave ai kishte "fituar të ardhura në shuma të mëdha", gjykata konstatoi se konfiskimi ishte i justifikuar sipas nenit 2 të ligjit të vitit 2008 (shih paragrafin 24 më poshtë). Gjykata shpjegoi gjithashtu se ky lloj konfiskimi nuk kërkonte vendosjen e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis krimit për të cilin ishte dënuar kërkueti dhe fitimit të pasurisë, siç ishte rasti me konfiskimin e zakonshëm të produkteve të krimit të trajtuar në nenet 91 dhe 92 të Kodit Penal (shih paragrafin 22 më poshtë). Gjykata argumentoi se prona e kërkuetit po konfiskohej sipas një procedure të veçantë që synonte të ardhurat nga krimi të personave të dënuar për krim të organizuar, procedurë e cila ishte krejtësisht e ndryshme nga konfiskimi i zakonshëm penal.

VENDIMI ULEMEK KUNDËR SERBISË

9. Më 27 korrik 2007, Gjykata e Apelit e Beogradit e hodhi poshtë urdhrin për konfiskim dhe urdhëroi rigjykim. Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata e Lartë nuk kishte përcaktuar kohën e saktë kur kishin marrë formë të prerë dënimet ndaj kërkuesit dhe, për rrjedhojë, nëse kërkesa e prokurorit për konfiskim ishte depozituar në kohën e duhur. Gjykata e Apelit konstatoi më tej se Gjykata e Lartë nuk kishte shqyrtuar mjaftueshëm të gjitha provat e ofruara nga kërkuesi.

10. Më 14 shkurt 2011, Gjykata e Lartë e Beogradit pranoi përsëri kërkesën për konfiskimin e pronës së kërkuesit, duke korrigjuar mospërputhjet e gjetura nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj datë 27 korrik 2007.

11. Më 3 prill 2012, Gjykata e Apelit e Beogradit konfirmoi urdhrin e konfiskimit të datës 14 shkurt 2011 (shih paragrafin 10 më lart). Ndër gjetjet e tjera, Gjykata e Apelit sqaroi natyrën e procedurës për konfiskimin e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti kriminal duke e dalluar atë nga sekuestrimi i zakonshëm i të ardhurave kriminale. Gjykata shpjegoi se konfiskimi i pasurive të fituara në mënyrë kriminale ishte një institut i posaçëm i së drejtës i drejtuar kundër pasurisë së personave të dënuar për krime veçanërisht të rënda, përfshirë krimin e organizuar, dhe se për shkak se personi ishte dënuar për krim të organizuar, ekzistonte prezumimi se prona e saj ishte fituar në mënyrë të paligjshme derisa të vërtetohej e kundërta. Pas shqyrtimit të plotë të ankesës së kërkuesit dhe gjetjeve faktike dhe ligjore të Gjykatës së Lartë të Beogradit, gjykata konstatoi se kërkuesi kishte pasur një mundësi të arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij dhe përsëriti konstatimin e kësaj gjykate se kërkuesi nuk kishte arritur të vërtetonte se pasurinë e kundërshtuar e kishte fituar në mënyrë të ligjshme. Gjykata u shpreh më tej se nuk ishte e nevojshme të përcaktohej asnjë lidhje konkrete midis një vepre penale të caktuar dhe fitimit të një pasurie për të zbatuar dispozitat për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë kriminale dhe se nuk ishte e nevojshme që të provohej vepra penale konkrete me anë të së cilës ishin fituar pasuritë. Gjykata shpjegoi se edhe pasuritë e fituara para kryerjes së veprave për të cilat ishte dënuar kërkuesi mund të sekuestroheshin sipas ligjit të vitit 2008, pasi nuk ishte e nevojshme provimi i asnjë lidhjeje midis këtyre veprave penale dhe pasurisë. Në fund, gjykata theksoi se masa e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë kriminale nuk ishte sanksion penal, por masë e veçantë për rikuperimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal. Gjykata arriti në përfundimin se, për këto arsye, dispozitat për ndalimin e efektit prapaveprues të ligjit penal nuk ishin të zbatueshme.

12. Më 10 korrik 2012, kërkuesi parashtroi një ankim kushtetues përmes së cilin ai u ankua për vendimin e përmendur më lart të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se vendimi cenonte parimin e mungesës së efektit prapaveprues të ligjit penal, si dhe të drejtat e tij procedurale dhe të drejtën e pronës.

13. Me vendimin e datës 26 nëntor 2012, dorëzuar kërkuesit më 5 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimin kushtetues të kërkuesit dhe la në fuqi vendimin e sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese pranoi interpretimin e Gjykatës së Apelit, sipas të cilit konfiskimi i pasurive kriminale nuk ishte as sanksion penal dhe as penal në natyrë. Ajo përsëriti se ky lloj konfiskimi nuk kërkon përcaktimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë kohore midis krimit për të cilin ishte dënuar kërkuesi dhe fitimit të pasurisë së kontestuar, ndryshe nga konfiskimi i zakonshëm i produkteve të krimit i trajtuar në Kodin Penal, por thjesht kërkohej prezumimi se prona ishte fituar në mënyrë të paligjshme derisa të vërtetohej e kundërta. Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parimi i mungesës së efektit prapaveprues të ligjit penal nuk ishte i zbatueshëm për çështjen në fjalë. Më tej, ajo konstatoi se ankesat e kërkuesit në lidhje me të drejtat e tij procedurale dhe pronësore ishin të pabaza dhe se ai kishte pasur mundësi të arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij.

2. Kërkesa e ankimesit për të rihapur procesin gjyqësor

14. Më 28 nëntor 2013, kërkuesi parashtrroi kërkesën e tij të parë për rihapjen e procesit gjyqësor për konfiskimin e pasurisë së tij.
15. Më 27 dhjetor 2013, Gjykata e Lartë e Beogradit e hodhi poshtë këtë kërkesë, duke u shprehur se një procedurë e tillë nuk parashikohej me ligj në lidhje me vendimet për konfiskimin e pasurisë. Më 22 janar 2014, Gjykata e Apelit e Beogradit e konfirmoi këtë vendim. Më 13 tetor 2014 kërkuesi depozitoi një padi lidhur me kushtetutshmërinë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.
16. Më 31 mars 2015, kërkuesi parashtrroi kërkesën e tij të dytë për rihapjen e procesit gjyqësor për konfiskimin e pasurisë së tij, duke e bazuar kërkesën e tij në përfundimin e Gjykatës së Lartë të Kasacionit, datë 16 qershor 2014 (shih paragrafin 32 më poshtë).
17. Më 28 maj 2015, Gjykata e Lartë e Beogradit e hodhi poshtë këtë kërkesë, duke konstatuar se nuk kishte arsye për rihapjen e procesit. Gjykata e Apelit e Beogradit e rrëzoi këtë vendim më 6 korrik 2015 dhe ia ktheu çështjen për rishqyrtim nga e para Gjykatës së Lartë të Beogradit.
18. Më 16 korrik 2015, Gjykata e Lartë e Beogradit e hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit si të pabazë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit e Beogradit më 4 shtator 2015. Gjykata e Apelit u shpreh, *ndër të tjera*, se faktet dhe provat e reja të pretenduara të paraqitura nga kërkuesi, përkatësisht se ai nuk kishte qenë pronar i pronave në fjalë, në asnjë rast nuk do të çonin në një përfundim në favor të tij, i cili përbënte kushtin bazë për rihapjen e procesit gjyqësor.
19. Më 4 korrik 2016, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi padinë e kërkuesit lidhur me kushtetutshmërinë (shih paragrafin 15 më lart). Për të vendosur për këtë çështje, gjykata mori gjithashtu parasysh përfundimin e Gjykatës së Lartë të Kasacionit (shih paragrafin 32 më poshtë) dhe vendimet e gjykatave të brendshme lidhur me kërkesën e dytë të kërkuesit për rihapjen e çështjes gjyqësore (shih paragrafin 16 më lart).

B. Ligji kombëtar dhe praktika gjyqësore e zbatueshme

1. Kushtetuta

20. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës, të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë (“GZ RS”), nr. 98/06, hynë në fuqi më 8 nëntor 2006 dhe parashikojnë si më poshtë:

Neni 34

“Asnjë person nuk mund të shpallet fajtor për një vepër që nuk përbënte vepër penale sipas ligjit ose ndonjë rregulloreje tjetër të bazuar në ligj në kohën kur është kryer vepra dhe as nuk mund të merret një dënim që nuk është parashikuar për këtë vepër.

Dënimet përcaktohen në bazë të rregullave/ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës, me përjashtim të rastit kur rregullimi i mëvonshëm është më i butë për autorin e veprës. Veprat penale dhe dënimet përcaktohen me ligj.”

Neni 58

“Gëzimi paqësor i pronës personale dhe e të drejtave të tjera pronësore të fituara me ligj duhet të garantohet (me ligj).

E drejta e pronësisë mund të revokohet ose kufizohet vetëm në interes të publikut, siç përcaktohet me ligj, me [pagimin e] kompensimit, i cili nuk mund të jetë më i vogël se vlera e tregut.

Mbi mënyrën e shfrytëzimit të pasurisë mund të vendosen kufizime me ligj.

Çdo sekuestrim ose kufizim në lidhje me pronën me qëllim mbledhjen e taksave dhe tarifave ose gjobave të tjera lejohet vetëm [kur një sekuestrim ose kufizim i tillë është] në përputhje me ligjin.”

2. Kodi Penal

21. Neni 4 i Kodit Penal, botuar në FZ të RS nr. 85/05, 88/05, 107/05, 72/09, 111/09, 121/12, 104/13, 108/14, 94/16 dhe 35/19, përcakton llojet e sanksioneve që mund të vendosen ndaj autorëve të veprës penale si vijon: dënimi (*kazna*), kujdesi (*mere upozorenja*), masat e sigurisë (*mere bezbednosti*) dhe masat edukative (*vaspitne mere*). Neni 43 i Kodit Penal rendit llojet e dënimeve, përkatësisht dënim me burgim të përjetshëm, burgim, gjobë, punë në shërbim të komunitetit dhe heqje patente.

22. Neni 91 parashikon shkaqet për sekuestrimin e produkteve pasurore të përfituar me vepër penale, sekuestrimi i së cilave duhet të kryhet në bazë të një vendimi gjykate që përcakton kryerjen e veprës penale. Në nenin 92, Kodi Penal përcakton kushtet dhe mënyrën e sekuestrimit të përfitimit të tillë material.

3. *Ligji për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit*

23. Ligji i vitit 2008 për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit (*Zakon o oduzimanju imovine proistekle iz krivičnog dela*), siç ishte në fuqi në kohën materiale, u botua në FZ RS nr. 97/08. Ligji u miratua më 27 tetor 2008 dhe hyri në fuqi më 1 mars 2009.

24. Neni 1 i ligjit të vitit 2008 përcakton kërkesat procedurale për autoritetet përgjegjëse për gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe menaxhimin e produkteve të krimit. Neni 2 thotë se ligji është i zbatueshëm për një listë të veprave kualifikuese, përfshirë krimin e organizuar, krimet kundër tregtisë, trafikimin e drogave narkotike, pornografinë e fëmijëve, krimet kundër rendit publik, shpërdorimin e detyrës, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit.

25. Neni 3 i ligjit të vitit 2008 parashikon se “pasuri” janë mallra të çdo lloji dhe instrumente të çdo forme. Ato përfshijnë gjithashtu të ardhura ose përfitime të tjera të krijuara, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një vepër penale, si dhe çdo pasuri në të cilat ato janë shndërruar ose me të cilën janë kombinuar. “Produktet e krimit” janë pasuritë e një të akuzuari, dëshmitari bashkëpunues (*svedok saradnik*) ose trashëgimlënësi (*ostavilac*) të cilat janë në mënyrë të dukshme jo në proporcion me të ardhurat e tij/saj të ligjshme. "Pronari" i referohet një personi të akuzuar, një dëshmitari bashkëpunues, trashëgimlënësi ose pasardhësi ligjor, ose një palë të tretë.

26. Sipas nenit 4, Kodi i Procedurës Penale është i zbatueshëm si bazë ligjore plotësuese në lidhje me çështjet procedurale që nuk parashikohen nga vetë ligji i vitit 2008. Nenet 8 deri në 14 themelojnë Drejtorinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe trajtojnë kompetencat dhe mënyrën e organizimit të saj. Nenet 15 deri në 20 rregullojnë hetimet financiare. Nenet 21 deri në 27 përshkruajnë kushtet dhe procedurën për sekuestrimin e përkohshëm të pronave.

27. Nenet 28 deri në 36 përcaktojnë procedurat për konfiskimin e pasurisë. Sipas nenit 28, prokurori mund të paraqesë kërkesë në gjykatë një vit pas ngritjes së aktpadisë dhe jo më vonë se një vit pas vendimit të formës së prerë në çështje penale. Kërkesa drejtohet kundër pronës dhe “pronarit” (shih paragrafin 25 më lart). Sipas nenit 34, gjykata mund të lëshojë një urdhër konfiskimi pasi të jetë bindur se ka një mospërputhje të dukshme ndërmjet të ardhurave të ligjshme të pronarit dhe vlerës së pasurisë së tij dhe se nuk ka arsye të tjera ligjore për blerjen e pronës së kundërshtuar nga pronari. Gjukata gjithashtu mund t'ua japë pasuritë e konfiskuara viktimave të krimeve të kryera nga pronari nëse padia civile e viktimave njihet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjukata gjithashtu mund të vendosë që të lejojë pronarin të mbajë një pjesë të pronës nëse konfiskimi i plotë i pronës do të rrezikonte jetesën e pronarit ose të vartësve të tij.

4. *Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë*

28. Gjukata Kushtetuese ka analizuar natyrën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë kriminale në vendimin e saj datë 30 qershor 2011 (IUz nr. 1242/10),

ku konstatoi se ligji i vitit 2008 ishte në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo vuri në dukje se instrumentet ndërkombëtare përkatëse e linin në dorë të Palëve Kontraktuese që të vendosnin nëse do ta trajtonin konfiskimin si dënim, apo si masë të kontrollit të pasurisë. Ajo pastaj vijoi me analizimin e natyrës së konfiskimit në sistemin juridik serb duke zbatuar praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate.

29. Gjykata Kushtetuese fillimisht konstatoi se konfiskimi nuk ishte renditur si sanksion penal në pjesët përkatëse të Kodit Penal të Serbisë, se proceset e konfiskimit ishin procese *in rem*, se gjykatat serbe nuk kishin filluar procese të tilla *ex proprio motu* pas një dënimi dhe se shuma e pasurisë së konfiskuar nuk varej nga niveli i fajësisë së pronarit, por nga shuma e mospërputhjes midis fitimeve të ligjshme të pronarit dhe vlerës së pasurisë së tij. Më tej, gjykata konstatoi se masa drejtohej mbi “pronën, pavarësisht se kush është pronari nominal i saj, jo mbi personin”. Gjykata Kushtetuese vuri në dukje se kjo tregonte se masa nuk kishte karakter penal pasi “nuk ishte zbatuar *ad personam* ndaj të akuzuarit, por *in rem*, pavarësisht fajësisë së tij”. Gjykata më pas deklaroi se masa e konfiskimit kishte natyrë parandaluese, por se qëllimi i saj parësor ishte të sigurohej që “krimi nuk paguhet” dhe, si rrjedhim, “të rikthente situatën që ekzistonte para kryerjes së veprës penale”. Sipas gjykatës, kjo ishte provë e qartë se masa është kryesisht e “natyrës restorative”. E gjithë kjo bëri që Gjykata Kushtetuese të arrinte në përfundimin se “konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë kriminale në sistemin ligjor serb nuk është sanksion penal, por përbën masë *sui generis* për kontrollin e pasurisë”.

30. Gjykata Kushtetuese e përsëriti këtë konstatim në vendimin e saj datë 13 mars 2012 (UŽ nr. 2805/09), ku konstatoi se në sistemin juridik të Serbisë masa e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë kriminale nuk përfaqësonte sanksion penal, por një masë kontrolli pasuror dhe, për këtë arsye për një masë që nuk ka natyrë penale nuk mund të shtrohej çështja e zbatimit prapaveprues të ligjit penal. Sipas Gjykatës Kushtetuese, qëllimi parësor i kësaj mase ishte parandalimi i përfitimit të personave në fjalë nga aktiviteti kriminal.

31. Gjykata e Lartë e Serbisë, në vendimin e saj KŽ II ok TOI 278/09 datë 20 nëntor 2009, gjithashtu konstatoi se konfiskimi i pronave të fituara në mënyrë kriminale nuk ishte sanksion penal, siç ishte e dukshme në çështjen para saj, pasi prona e konfiskuar i përkiste pasardhësve ligjorë të dy individëve të vdekur, të cilët nuk ishin dënuar kurrë për vepra të krimit të organizuar. Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se konfiskimi ishte një masë kontrolli pasuror e krijuar për të parandaluar pasurimin përmes aktiviteteve kriminale.

32. Më 16 qershor 2014, dhoma penale e Gjykatës së Lartë të Kasacionit vendosi që rihapja e procesit gjyqësor për sekuestrimin e produkteve të krimit i përfunduar me vendim të formës së prerë (“*rešenje*”) do të lejohej sipas rregullave për rihapjen e procesit penal të përfunduar me vendim të formës së prerë, pavarësisht se forma e vendimit në procesin e mëparshëm quhej “vendim” dhe jo “aktgjykim”, me arsyetimin se një vendim i tillë i formës së prerë në një proces gjyqësor për sekuestrimin e produkteve të krimit është ligjërisht i barasvlefshëm me një aktgjykim të formës së prerë në një proces penal.

C. Dokumentet ndërkombëtare me rëndësi

1. Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 1990 për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit

33. Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 1990 për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit (ETS nr. 141), e cila hyri në fuqi në lidhje me Serbinë më 1 shkurt 2004, parashikon se një nga "metodat moderne dhe efektive" për "luftën kundër krimeve të rëndë ... konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit" (shih Preambulën e Konventës).

34. Konventa e vitit 1990 u bën thirrje shteteve palë të "miratojnë masa të tilla legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për t'u mundësuar [atyre] konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të krimit ose pronës vlera e të cilave korrespondon me këto produkte" (shih nenin 2). Në të njëjtën kohë, termi "konfiskim" përkufizohet si "dënim ose një masë e urdhëruar nga një gjykatë pas proceseve gjyqësore në lidhje me një vepër penale ose disa vepra penale që çonin në privimin përfundimtar nga prona" (shih nenin 1).

35. Raporti shpjegues i Konventës së 1990 sqaron më tej termat ligjorë përkatës:

"15. ... Ekspertët ishin gjithashtu në gjendje të identifikonin dallime të konsiderueshme në lidhje me organizimin procedural të marrjes së vendimeve për konfiskimin (vendimet e marra nga gjykatat penale, gjykatat administrative, autoritetet e posaçme gjyqësore, në proceset civile ose penale krejtësisht të veçanta nga ato ku përcaktohet fajësia e autorit (këto procese njohen në tekstin e Konventës si 'proces për qëllime konfiskimi' dhe në raportin shpjegues ndonjëherë si 'proces in rem'). Gjithashtu, ishte e mundur të shiheshin dallime në lidhje me kuadrin procedural të vendimeve të tilla (prezumimet e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, afatet, etj.) ...

23. Komiteti diskutoi nëse ishte e nevojshme të përcaktohej "konfiskimi" ose "urdhri i konfiskimit" sipas Konventës. ... Përkufizimi i 'konfiskimit' u hartua për të bërë të qartë se, nga njëra anë, Konventa trajton vetëm aktivitetet kriminale ose aktet e lidhura me to, të tilla si aktet që lidhen me veprimet civile *in rem* dhe, nga ana tjetër, se dallimet në organizimin e sistemeve gjyqësore dhe rregullat e procedurës nuk e përjashtojnë zbatimin e Konventës. Për shembull, fakti që konfiskimi në disa shtete nuk konsiderohet si sanksion penal, por si masë sigurie ose masë tjetër është i parëndësishëm sa i takon masës që konfiskimi lidhet me aktivitetin kriminal. Është gjithashtu e parëndësishme të vërehet se konfiskimi ndonjëherë mund të urdhërohet nga një gjyqtar i cili, në mënyrë strikte, nuk është gjyqtar penal, por mjafton që vendimi është marrë nga një gjyqtar. Termi 'gjykatë' ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekspertët ranë dakord se konfiskimi thjesht administrativ nuk ishte përfshirë në fushën e zbatimit të Konventës."

2. *Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 2005 për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit*

36. Në vitin 2005, Këshilli i Evropës miratoi një Konventë tjetër, më gjithëpërfshirëse, për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit (ETS nr. 198). Konventa ka hyrë në fuqi në lidhje me Serbinë më 1 gusht 2009.

37. Nenet 3 dhe 5 të Konventës së 2005, për aq sa lidhen me këtë çështje, parashikojnë si më poshtë:

Neni 3 – Masat për konfiskim

“4. Çdo Palë do të miratojë masa të tilla legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të kërkuar që, në lidhje me një shkelje të rëndë ose shkelje të përcaktuara nga ligji kombëtar, një autor të tregojë origjinën e të ardhurave të pretenduara ose pronës tjetër që mund të konfiskohet në masën që kjo kërkesë është në përputhje me parimet e ligjit të brendshëm”.

Neni 5 – Ngrirja, sekuestrimi dhe konfiskimi

“Çdo Palë do të miratojë masa legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që masat për ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin të përfshijnë gjithashtu:

(a) pronën në të cilën janë transformuar ose konvertuar produktet;

(b) pasurinë e fituar nga burime legjitime, nëse produktet janë përzier, tërësisht ose pjesërisht, me një pasuri të tillë, deri në vlerën e vlerësuar të produkteve të përziera;

(c) të ardhurat ose përfitimet e tjera që rrjedhin nga të ardhurat, nga pasuria në të cilën janë shndërruar ose konvertuar produktet e krimit, ose nga pasuria me të cilën janë përzier produktet e krimit, deri në vlerën e vlerësuar të produkteve të përziera, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si produktet.”

38. Raporti shpjegues i Konventës së 2005-ës riafirmoi gjithashtu se:

“39. Përkufizimi i 'konfiskimit' është hartuar për të bërë të qartë se, nga njëra anë, Konventa e vitit 1990 trajton vetëm aktivitetet kriminale ose aktet e lidhura me to, të tilla si aktet që lidhen me padi civile *in rem* dhe, nga ana tjetër, se dallimet në organizimin e sistemeve gjyqësore dhe rregullat e procedurës nuk e përjashtojnë zbatimin e Konventës së 1990-ën dhe të kësaj Konvente. Për shembull, fakti që konfiskimi në disa shtete nuk konsiderohet si sanksion penal, por si masë sigurie apo masë tjetër, është i parëndësishëm në masën që konfiskimi lidhet me aktivitetin kriminal. Është gjithashtu e parëndësishme që konfiskimi ndonjëherë mund të urdhërohet nga një gjyqtar i cili, në mënyrë strikte, nuk është gjyqtar penal, për aq kohë sa vendimi është marrë nga një gjyqtar.

...

VENDIMI ULEMEK KUNDËR SERBISË

71. Paragrafi 4 i nenit 3 kërkon që Palët të ofrojnë mundësinë e tjetërsimit të barrës së provës në lidhje me origjinën e ligjshme të produkteve të pretenduara ose pronës tjetër që mund të konfiskohet në raste të veprave të rënda ...

76. Kjo dispozitë nënvizon veçanërisht nevojën për të zbatuar masa të tilla edhe për produktet që janë përzier me pronën e fituar nga burime të ligjshme ose të transformuara ose konvertuara në mënyrë tjetër.

ANKESAT

39. Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 7 § 1 të Konventës se zbatimi i masës së konfiskimit në rastin e tij shkelte parimin e mungesës së efektit prapaveprues të ligjit penal. Për më tepër, duke u mbështetur në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesi u ankua se konfiskimi i pronës në rastin e tij shkelte të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pronës.

LIGJI I ZBATUESHËM

A. Fusha e veprimit e çështjes

40. Në përgjigje të konstatimeve të parashtruara nga qeveria, kërkuesi përsëriti ankesat e tij mbështetur në nenin 6 të Konventës duke pretenduar padrejtësi të procesit gjyqësor, të cilat ai i kishte ngritur tashmë në formularin e tij të aplikimit. Ai gjithashtu ngriti një ankesë të re, në thelb mbështetur në nenin 6, në lidhje me kërkesat e tij për rihapjen e procesit gjyqësor (shih paragrafët 14-19 më lart).

41. Sa i përket ankesave në bazë të nenit 6, të cilat fillimisht u ngritën në formularin e aplikimit, Gjykata vëren se ato tashmë janë shpallur të papranueshme (shih paragrafin 3 më lart). Për sa i përket ankesës tjetër në lidhje me kërkesën e kërkuesit për rihapjen e procesit gjyqësor, në thelb mbështetur në nenin 6 të Konventës, Gjykata vëren se kjo ankesë nuk ishte pjesë e kërkesës fillestare mbi të cilën ka komentuar qeveria. Prandaj, Gjykata nuk e konsideron të përshtatshme ta shqyrtojë këtë çështje veçmas në këtë fazë (shih, për shembull, *Maznyak kundër Ukrainës*, nr. 27640/02, § 22, 31 janar 2008, dhe *Kuncheva kundër Bullgarisë*, nr. 9161/02, § 18, 3 korrik 2008). Kërkuesi kishte mundësinë të paraqiste një kërkesë të re në lidhje me çdo ankesë tjetër që kishte të bënte me ngjarjet e mëvonshme në çështjen e tij në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 47 të Rregullores së Gjykatës.

B. Ankimi në bazë të nenit 7 § 1 të Konventës

42. Kërkuesi u ankua se, në bazë të nenit 7 § 1 të Konventës, konfiskimi i pronës së tij ishte në kundërshtim me parimin e mungesës së prapaveprimit të ligjit penal. Ai argumentoi se kjo masë ishte ekuivalente me një sanksion penal dhe se do të ishte e pamundur të zbatohet në rastin e tij pasi nuk ajo kishte ekzistuar në kohën e kryerjes së krimeve për të cilat ai ishte dënuar më parë.

43. Neni 7 § 1 parashikon si më poshtë:

“1. Askush nuk do të dënohet për një vepër penale për shkak të ndonjë veprimi ose mosveprimi që nuk përbënte vepër penale sipas ligjit kombëtar ose ndërkombëtar në kohën e kryerjes së veprës. Gjithashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se dënimi i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale.”

1. *Argumentet e palëve*

44. Kërkuesi përsëriti ankesën e tij.

45. Qeveria pohoi se konfiskimi i pasurive të kërkuesit ishte një masë *sui generis*, e cila ishte parandaluese dhe jo penale, siç u pasqyrua në natyrën përshkruese dhe qëllimin e masës dhe gjithashtu në përshkrimin e saj në legjislacionin kombëtar dhe procedurën dhe zbatimin e tij. Qeveria u shpreh më tej se qëllimi i pasurisë që do të sekuestrohej nuk ishte i lidhur me nivelin e fajit të një personi të dënuar, por ishte përcaktuar në përputhje me një kriter krejtësisht të ndryshëm, përkatësisht me masën në të cilën pasuritë tejkalonin të ardhura e ligjshme origjinale të pronarit.

2. *Vlerësimi i Gjykatës*

46. Për qëllimet e Konventës nuk mund të ketë "dënim" nëse nuk është vërtetuar në përputhje me ligjin se është kryer një vepër, e cila mund të jetë vepër penale ose, sipas rastit, edhe një shkelje disiplinore. Në mënyrë të ngjashme, nuk mund të ketë dënim nëse nuk përcaktohet përgjegjësia personale (shih *Varvara kundër Italisë*, nr. 17475/09, § 69, 29 tetor 2013, dhe *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* [GC], nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, § 251, 28 qershor 2018).

47. Koncepti i “dënimit” në nenin 7 ka kuptim autonom. Për ta bërë efektive mbrojtjen e ofruar nga ky nen, Gjykata duhet të jetë e lirë të shkojë pas perceptimeve/dukjeve dhe të vlerësojë vetë nëse një masë e caktuar përbën në thelb një "dënim" sipas kuptimit të kësaj dispozite. Formulimi i nenit 7 § 1, fjalia e dytë, tregon se pikënisja e çdo vlerësimi mbi ekzistencën e një “dënimi” është nëse masa në fjalë është dhënë pas një vendimi fajësie ndaj një personi për një vepër penale. Megjithatë, faktorë të tjerë mund të merren parasysh si të rëndësishëm në lidhje me këtë, përkatësisht natyra dhe qëllimi i masës në fjalë; përshkrimi i saj sipas ligjit kombëtar; procedurat e përfshira në marrjen dhe zbatimin e masës; dhe ashpërsia e saj (*shih G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët*, cituar më lart, §§ 210-211§§ dhe praktikën gjyqësore të cituar në të dhe gjithashtu *Ilneher kundër Gjermanisë* [GC], nr. 10211/12 dhe 27505/14, § 203, 4 dhjetor 2018).

48. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, për sa i përket lidhjes ndërmjet urdhrave të konfiskimit të pasurive të kërkuesve dhe një vepre penale të caktuar, Gjykata vëren se konfiskimi sipas nenit 2 të ligjit të vitit 2008 mund të bëhet vetëm nëse ekziston një dënim për një nga krimet e rënda të renditura në atë dispozitë, përfshirë edhe krimin e organizuar (shih paragrafin 24 më lart). Prandaj, urdhrat e konfiskimit janë të lidhura dhe varen nga kryerja e një vepre penale është mjaftueshmërisht e rëndë.

49. Sa i përket përshkrimit të masës së kundërshtuar sipas ligjit të brendshëm, Gjykata vëren se gjykatat serbe ishin unanime në përfundimin e tyre se konfiskimi i pasurive të fituara në mënyrë kriminale nuk përbënte një dënim sipas kuptimit të nenit 34 § 2 të Kushtetutës dhe nenit 7 § 1 të Konventës (shih paragrafët 10, 11 dhe 13 më lart). Duke pasur parasysh kriteret e zhvilluara në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate, ato konstatuan se konfiskimi i pasurisë nuk ishte një dënim shtesë, por pasojë e faktit se autori ose përfituesit e tjerë kishin përfituar pasuri me origjinë nga një veprim i kundërligjshëm. Gjykata vëren në lidhje me këtë se dënimet dhe konfiskimi konsiderohen si masa të posaçme në sistemin ligjor serb. Kjo ilustron nga fakti se konfiskimi i pasurive kriminale nuk përfshihet në listën e sanksioneve penale të parashikuara në Kodin Penal (shih paragrafin 21 më lart). Në fakt, instituti i konfiskimit të pasurisë kriminale i cili u zbatua në rastin e kërkuesit nuk rregullohet me Kodin Penal të Serbisë, por me një legjislacion krejtësisht të ndryshëm, përkatësisht Ligjin e vitit 2008. Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës, nuk ka asgjë në legjislacionin përkatës që e klasifikon qartë masën *si dënim* (shih, *a contrario*, *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerë*, cituar më sipër, §§ 220-221). Fakti që Kodi i Procedurës Penale zbatohet si legjislacion plotësues dhe se një dhomë e posaçme e një gjykate penale dha urdhrin e konfiskimit (shih paragrafin 55 më poshtë) nuk e ndryshon këtë përfundim.

50. Lidhur me vlerësimin e natyrës dhe qëllimit të urdhrave të konfiskimit, Gjykata vëren se, sipas gjykatave kombëtare, masat e përcaktuara në ligjin e vitit 2008 synonin të përmbushnin detyrimet e parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit (shih paragrafin 33 më lart) (shih *Fondacioni Dassa dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (vendim), nr. 696/05, 10 korrik 2007, lidhur me një sekuestrim të pronave të urdhëruar nga gjykatat penale gjatë rrjedhës së hetimeve gjatë proceseve objektive të konfiskimit, dhe *Balsamo kundër San Marino*, nr. 20319/17 dhe 21414/17, § 62, 8 tetor 2019, lidhur me një konfiskim të bërë në një proces penal). Pra, urdhrat e konfiskimit kishin për qëllim të siguronin që krimi nuk paguan dhe ishin kryesisht me natyrë restorative.

51. Në çështjen *Dassa Foundation dhe të tjerët* (cituar më lart), Gjykata konstatoi se urdhrat e sekuestrimit nuk përbënin “dënim” sipas kuptimit të nenit 7 § 1, fjalia e dytë, sepse natyra e konfiskimit sipas ligjit të brendshëm, edhe pse e rregulluar në Kodin Penal dhe e lidhur dhe e varur nga kryerja e një vepre penale, e bënte atë më të krahasueshëm me kthimin e pasurimit të padrejtë sipas ligjit civil, sesa me një dënim sipas ligjit penal.

Në veçanti, Gjykata vërejtë se konfiskimi sipas ligjit të Lihtenshtajnit mund të përjashtohet për aq kohë sa palët e treta kishin pretendime ligjore në lidhje me pronat në fjalë; konfiskimi ishte i kufizuar në pasurimin aktual të përfituesit të një veprë penale; nuk ka prezumime ligjore se prona që kalonte nga dora e autorit përpara veprës penale ishte fryt i krimit, përveç nëse ai mund të provonte të kundërtën; shkalla e fajësisë së autorit të veprës ishte e parëndësishme për përcaktimin e sasisë së pasurisë së deklaruar të konfiskuar; dhe urdhrat e konfiskimit nuk mund të zbatoheshin me burgim në mungesë të pagesës (po aty).

52. Kohët e fundit në çështjen *Balsamo* (citur më lart), Gjykata konstatoi gjithashtu se masa e konfiskimit, edhe pse zbatohet nga gjykatat e juridiksionit penal, nuk mund të konsiderohet ndëshkuese, por më tepër parandaluese, për arsyet e mëposhtme. Së pari, konfiskimi sipas ligjit të brendshëm ishte i zbatueshëm edhe nëse objektet nuk i përkisnin autorit të veprës në fjalë. Së dyti, sipas doktrinës përkatëse vendase parandalimi parashikohet si masë parandaluese, e pavarur nga procesi penal dhe konstatimi i fajit. Së treti, Gjykata pranoi se masa ishte projektuar për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të produkteve të krimit dhe kryerjen e krimeve të mëtejshme, gjë që kishte qenë objektivi i kërkuar edhe nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare. Përfundimisht, ajo përsëriti se ashpërsia e masës nuk ishte në vetvete vendimtare (po aty).

53. Gjykata gjithashtu vëren se disa karakteristika të sistemit serb të konfiskimit të pasurisë kriminale sipas ligjit të 2008-ës e bëjnë atë të krahasueshëm me institutin e konfiskimit civil *in rem*, dhe jo me dënimin sipas ligjit penal. Së pari, Gjykata vëren se formulimi i legjislacionit përkatës sugjeron fuqishëm se sistemi drejtohet kundër pronës, jo kundër personit. Kjo është e dukshme nga fakti se konfiskimi mund të urdhërohet edhe kundrejt një pasurie që i përket një personi të tretë nëse kjo pasuri e ka origjinën nga një krim dhe personi i tretë nuk ka pretendime ligjore të vlefshme lidhur me të në pajtim me parashikimin e nenit 28 të ligjit të vitit 2008. (shih paragrafin 27 më lart) (krahaso *Balsamo*, cituar më lart, § 62). Së dyti, ligji i vitit 2008 njeh mundësinë e konfiskimit të pasurisë së një personi të vdekur i cili nuk ka qenë i akuzuar ose dënuar për asnjë krim, nëse dyshimi se një pasuri e tillë përbën produkte të krimit lind nga faktet e vërtetuara në procesin penal kundër një pale të tretë. Së treti, në rastin e konfiskimit të pasurive kriminale, ndryshe nga rasti i dënimit të ligjit penal, niveli i fajit të shkelësit është i parëndësishëm për përcaktimin e sasisë së pasurive të deklaruar të konfiskuara (shih *Fondacioni Dassa dhe të tjerët*, cituar më sipër dhe, *a contrario*, *Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 shkurt 1995, § 33, Seria A nr. 307-A). Së katërti, urdhrat e konfiskimit sipas ligjit të vitit 2008 nuk mund të zbatohen me burgim në mungesë të pagesës që është një element i rëndësishëm i dënimeve të ligjit penal (shih *Fondacioni Dassa dhe të tjerët*, cituar më lart dhe, *a contrario*, *Welch*, i cituar më lart). Së fundi, gjatë lëshimit të urdhrit për konfiskim, gjykatat serbe gjithashtu mund të vendosin të ndanin një pjesë të pronave, ose të gjitha ato për kompensimin e viktimave,

nëse paditë civile të këtyre të fundit do të ishin pranuar me vendime gjyqësore të formës së prerë, gjë që është e krahasueshme më shumë me kthimin e pasurimit të padrejtë sipas ligjit civil, sesa me një dënim sipas ligjit penal (shih *Fondacioni Dassa dhe të tjerët*, cituar më sipër).

54. Gjykata vëren se në çështjen *Dassa Foundation dhe të tjerët* (cituar më lart) se mungesa e prezumimeve ligjore që prona e zotëruar nga një autor vepra para kryerjes së veprës penale përfaqësonte produkte të krimit, përveç nëse ai mund të provonte të kundërtën, ishte një ndër faktorët që e dallonte atë çështje nga çështja *Welch* (cituar më lart) ku ky prezumim kishin qenë i pranishëm. Megjithëse ligji i vitit 2008 nuk parashikon një listë të prezumimeve të detyrueshme të ngjashme me prezumimin në çështjen *Welch* (cituar më lart, §§ 12 dhe 33), ai ka një përkufizim mjaft të gjerë të "të produkteve të krimit" (shih paragrafin 25 më lart) bazuar në të cilin gjykatat serbe mund të vendosin një urdhër konfiskimi në lidhje me çdo pasuri të zotëruar nga autori i veprës (ose çdo personi të cilit i është transferuar pasuria që nuk ka paguar vlerën e plotë për to) të cilat nuk janë të shpjgueshme nga të ardhurat e tij/saj të ligjshme. Ky, në fakt, është aspekti i vetëm i lëshimit të urdhrit sipas Ligjit të 2008-ës, i cili është i ndryshëm nga ai në rastin e *Fondacionit Dassa dhe të tjerët* (cituar më lart). Gjykata vëren se, ndryshe nga rasti i lartpërmendur, ligji i vitit 2008 parashikon vepra penale për të cilat mund të zbatohen dispozitat e tij, në veçanti veprat penale që përmbajnë elementin e krimit të organizuar, disa vepra penale të kryera kundër tregtisë dhe krimet kundër njerëzimit, si dhe krimet e lidhura me funksione publike (shih paragrafin 24 më lart). Gjykata vëren se, veçanërisht në kontekstin e krimit të organizuar, akumulimi i burimeve financiare është thelbësor për funksionimin e rrjetit kriminal. Goditja ndaj fondeve të grupeve kriminale dhe sigurimi që kriminelët nuk do të përfitojnë nga aktivitetet e paligjshme është një çështje kyçe për parandalimin e kriminalitetit. Për të luftuar në mënyrë më efektive këtë krim, ligji i vitit 2008 u jep të drejtë gjykatave që të nxjerrin një urdhër konfiskimi bazuar në prova të mjaftueshme se origjina e pasurisë është e paligjshme. Kjo provë, sipas praktikës gjyqësore konsistente, mund të jetë mospërputhja midis vlerës së pasurisë dhe të ardhurave legjitime të një kriminelit dhe paaftësisë së tij për të provuar origjinën e ligjshme të pasurisë (shih *M. kundër Italisë*, nr. 12386/86, Vendimi i Komisionit i datës 15 prill 1991, në lidhje me konfiskimin e pronës nga një person i dyshuar si anëtar i një organizate të tipit mafioz, dhe *Balsamo*, cituar më sipër, § 63). Gjykata vlerëson se ky sfond ligjor konfirmon karakterin parandalues të konfiskimit dhe tregon se ai është krijuar për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të pronës që është objekt i urdhrit (shih *M. kundër Italisë*, cituar më sipër). Duke pasur parasysh këtë, dhe veçanërisht duke marrë parasysh kombinimin e të gjithë elementëve të tjerë jondëshkues të përshkruar më sipër (shih paragrafin 53 më lart), mundësia e mbështetjes te prezumimi sipas Ligjit të 2008 nuk mund të konsiderohet në vetvete si vendimtare kur bëhet fjalë për për të përcaktuar natyrën dhe qëllimin e masës.

55. Për sa i përket procedurave të përfshira në urdhërimin dhe zbatimin e masës, Gjykata vëren se urdhri i konfiskimit është bërë nga një dhomë e posaçme e një gjykate penale në një proces gjyqësor të posaçëm konfiskimi, vlerësimi i së cilës ka qenë objektiv dhe i bazuar në provat përkatëse në mungesa e një kundërshtimi të suksesshëm dhe pas dënimit përfundimtar të kërkuesit (shih, *mutatis mutandis*, *Balsamo*, cituar më sipër, § 63). Procesi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin e hartuar posaçërisht për rregullimin e proceseve objektive të konfiskimit, përkatësisht ligjin e vitit 2008.

56. Për sa i përket ashpërsisë së urdhrave të kundërshtuar, Gjykata kujton se ashpërsia e masës në fjalë nuk është në vetvete vendimtare, pasi shumë masa jo penale mund të kenë një ndikim thelbësor mbi personin në fjalë (shih *Del Río Prada k. Spanja* [GC], nr.42750/09, § 82, GJEDNJ 2013, dhe *Balsamo*, cituar më sipër, § 64). Gjykata vëren se një urdhër konfiskimi mund të ketë ndikim mbi prona me vlerë të konsiderueshme, pa pasur një kufi të epërm lidhur me shumën e pronave të konfiskuara. Megjithatë, konfiskimi zbatohet vetëm për pasurinë, origjina ligjore e së cilës nuk mund të gjurmohet. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, sipas nenit 34 të ligjit të vitit 2008 (shih paragrafin 27 më lart), gjykatat serbe kanë të drejtë të mos prekin një sasi të caktuar të pronës, edhe pse me origjinë nga aktivitetet kriminale, nëse konfiskimi i plotë do të rrezikonte jetesën e pronarit ose jetesën e vartësve të tij.

57. Duke shqyrtuar të gjithë faktorët përkatës për vlerësimin e ekzistencës së dënimit, Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh, në veçanti, natyrën e konfiskimit sipas ligjit të vitit 2008, i cili e bën atë të krahasueshëm me një konfiskim civil, urdhri i konfiskimit i lëshuar kundër kërkuesit nuk përbën “dënim” sipas kuptimit të nenit 7 § 1, fjalia e dytë, e Konventës.

58. Nga kjo rrjedh se neni 7 nuk është i zbatueshëm në rastin konkret. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet si e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

C. Ankesa në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës

59. Kërkuesi u ankua se konfiskimi i pronës së tij shkelte të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pronës, në veçanti se ishte arbitrare të zgjerohet fusha e mekanizmit të konfiskimit në mënyrë prapavepruese. Ai u mbështet në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, përveçse për interesin publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

VENDIMI ULEMEK KUNDËR SERBISË

Megjithatë, dispozitat e mësipërme nuk cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje të tilla që ai i konsideron të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve ose detyrimeve të tjera.”

1. Argumentet e palëve

60. Kërkuesi ripërsëriti ankesën e tij.

61. Qeveria nuk e kundërshtoi pretendimin që masa në diskutim në çështjen në fjalë përbënte ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës nga kërkuesi. Megjithatë, ajo vlerësoi se procesi për sekuestrimin e produkteve të krimiut i kryer kundër kërkuesit ishte në përputhje të plotë me dispozitat materiale dhe procedurale të ligjit të brendshëm dhe me dispozitat e Konventës. Përderisa kërkuesi nuk kishte arritur të provonte origjinën e ligjshme të fondeve të përdorura për blerjen e pronave në fjalë, prezumimi i parashikuar nga ligji i vitit 2008 ishte përmbushur. Si përfundim, qeveria e konsideroi konfiskimin e pasurive të kërkuesit si masë në përpjesëtim me objektivin legjitim të ndjekur.

2. Vlerësimi i Gjykatës

62. Gjykatës nuk i kërkohet të shqyrtojë në mënyrë abstrakte përputhshmërinë e dispozitave të ligjit të vitit 2008 me Konventën. Përkundrazi, ajo duhet të përcaktojë nëse mënyra në të cilën janë zbatuar këto dispozita në rastin e kërkuesit ka shkaktuar shkelje të Konventës (shih, ndër autoritetet e tjera, *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 41087/98

§ 41, ECHR 2001-VII, dhe *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], nr. 36480/07, § 107, 11 dhjetor 2018). Gjykata vëren, siç nuk u kundërshtua nga palët, se urdhri i konfiskimit në lidhje me pasuritë e kërkuesit përbën ndërhyrje në të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pronave dhe se neni 1 i Protokollit nr. 1 është i zbatueshëm në këtë çështje. Gjykata vëren gjithashtu se ndërhyrja përbënte kontroll të përdorimit të pronës sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (shih, ndër shumë autoritete të tjera, *Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 5 maj 1995,

§ 34, Seritë A nr. 316-A; *Veits kundër Estonisë*, nr. 12951/11, § 70, 15 kanar 2015; *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, nr. 36862/05, § 94, 12 maj 2015; *Telbis dhe Viziteu kundër Rumanisë*, nr. 47911/15, § 69, 26 qershor 2018; dhe *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* (vend.), nr. 52439/99, 4 shtator 2001).

63. Për sa i përket ligjshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata vëren se konfiskimi i pronës së kërkuesit u urdhërua nga gjykatat vendase në bazë të ligjit të vitit 2008. Duke pasur parasysh formulimin e dispozitave të këtij ligji, Gjykata vlerëson se nuk mund të ketë asnjë dyshim për qartësinë, saktësinë ose parashikueshmërinë e tyre (shih, për shembull, *Khoniakina kundër Gjeorgjisë*, nr. 17767/08, § 75, 19 qershor 2012, dhe *Grifhorst kundër Francës*, nr. 28336/02, § 91, 26 shkurt 2009).

64. Për sa i përket argumentit të kërkuarit se është arbitrare të zgjerohet fusha e mekanizmit të konfiskimit në mënyrë prapavepruese mbi pronën që ai kishte fituar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2008, Gjykata përsërit se kërkesa për "ligjshmëri" e parashikuar në nenin 1 i Protokollit nr. 1 normalisht nuk mund të interpretohet si pengim i legjislativit që të kontrollojë përdorimin e pronës ose të ndërhyjë në tjetër mënyrë në të drejtat materiale nëpërmjet dispozitave të reja me efekt prapaveprues që rregullojnë situatat faktike të vazhdueshme ose të reja ligjore (shih *Arras dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 17972/07, § 81, 14 shkurt 2012; *Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s. dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 48357/07 dhe 3 të tjera, § 104, 24 qershor 2014; *Khoniakina*, cituar më lart, 74; *Huitson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 50131/12, §§ 31-35, 13 janar 2015; dhe *Gogitidze dhe të tjerët*, cituar më lart, § 99). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se konfiskimi i pasurisë së kërkuarit është bërë në përputhje të plotë me kërkesën për "ligjshmëri" që parashikohet në nenin 1 të Protokollit nr. 1.

65. Për sa i përket legjitimitetit të qëllimit të konfiskimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se masa përbën një pjesë thelbësore të një pakete më të madhe legislative që synon intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar. Paketa është krijuar kryesisht për të privuar një person nga fitimet e marra nga përfshirja në aktivitete kriminale dhe, më e rëndësishmja, për të hequr vlerën e produkteve të krimit nga përdorimi i mundshëm në të ardhmen në aktivitete kriminale. Për rrjedhojë, qëllimi i masës është jo vetëm të sigurojë që krimi nuk paguan, por edhe të parandalojë qarkullimin e pasurive për të çuar përpara organizimet kriminale (shih, *mutatis mutandis*, Phillips, cituar më lart, § 52). Pra, duke pasur parasysh përfundimet e Gjykatës në lidhje me natyrën e masës sipas ligjit të vitit 2008 (shih paragrafin 57 më lart), ajo vëren se qëllimi i procesit gjyqësor të kundërshtuar ishte për më tepër të parandalonte pasurimin e padrejtë nëpërmjet krimeve të rënda, duke dërguar një sinjal të qartë për personat e përfshirë në krime të tilla ose që mendojnë të përfshihen në krime të tilla se veprimet e tyre të gabuara, edhe në rast se ata kalojnë të pacenuar nga sistemi i drejtësisë penale, prapëseprap nuk do të sigurojnë përfitime materiale as për ta dhe as për familjet e tyre (shih, *mutatis mutandis*, *Gogitidze dhe Të tjerët*, cituar më sipër, § 102). Përveç kësaj, masa kishte elemente të qarta restorative, pasi gjykatat serbe ishin në gjendje t'ua jepnin pronën e konfiskuar viktimave të krimeve të kryera nga pronarët ose paraardhësit e tyre (shih paragrafin 27 më lart).

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se masa e konfiskimit në çështjen në fjalë është kryer në përputhje me interesin e përgjithshëm për të siguruar që përdorimi i pronës në fjalë nuk sjell një avantazh për kërkuarin në dëm të komunitetit (krahaso *Raimondo kundër Italisë*, 22 shkurt 1994, § 30, Seritë A nr. 281-A; *Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vend.), nr. 52024/99, 5 korrik 2001; *Phillips*, cituar më sipër, § 52; dhe *Gogitidze dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 103).

VENDIMI ULEMEK KUNDËR SERBISË

67. Për sa i përket proporcionalitetit të konfiskimit të kundërshtuar me qëllimin e ndjekur të përmendur më lart, Gjykata vëren se kërkuesi i ka kufizuar argumentet e tij në kërkesën e parashtruar te zbatimi prapaveprues i mekanizmit të konfiskimit sipas ligjit të vitit 2008. Duke pasur parasysh informacionin e disponueshëm në dosjen e çështjes, nuk ka asgjë që sugjeron se konfiskimi i shtëpisë së kërkuetit ishte joproporcional dhe as ai vetë nuk e pretendon një gjë të tillë. Në këtë aspekt, Gjykata vëren veçanërisht se sipas gjetjeve të gjykatave kombëtare, kërkuesi kishte fituar sasi të mëdha të ardhurash nëpërmjet krimeve që kishte kryer. Duke qenë kështu, Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtat pronësore të kërkuetit nuk është jo përpjestimore në raport me objektivin legjitim të ndjekur.

68. Bazuar në sa më lart, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe, si e tillë, duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata,

Deklaron, me shumicë, ankesën në lidhje me nenin 7 të Konventës të papranueshme;

Deklaron, unanimisht, ankesën në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 11 mars 2021.

Stanley Naismith
Sekretar

Jon Fridrik Kjølbrot
President